



Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar

MESAZH NGA DREJTUESIT E PROGRAMIT AASF

Jemi të lumtur të ndajmë me ju buletin tonë të katërt, një produkt i Programit AASF, i cili synon të ndajë me publikun informacione rreth aktiviteteve më të fundit dhe atyre të ardhshme të projektit. Ashtu si AASF, ky buletin i drejtohet të gjitha palëve të interesit, bankave, institucioneve mikro - financiare, fermerëve, sipërmarrësve, si dhe kompanive dhe individëve që janë përfutur në sektorin bujqësor në Shqipëri, si ata që janë të angazhuar në sektorin prodhues dhe përpunues të produkteve bujqësore, tregtinë e pajisjeve bujqësore, si dhe ofruesit e shërbimeve të agrobiznesit.

Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF) është një program i financuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në bashkëpunim dhe me mbështetje të Qeverisë së Shqipërisë, i cili ka nisur aktivitetin e tij në vitin 2016.

Qëllimi i projektit është të mbështesë institucionet financiare shqiptare për të financuar një sektor jetik dhe me potencial të gjerë të pashfrytëzuar të ekono-

misë shqiptare - bujqësinë dhe agrobiznesin. AASF bazohet në dy shtylla siç janë mbështetja financiare dhe asistencë teknike.

AASF synon të arrijë qëllimin e saj përmes mbështetjes së Institucioneve Financiare Partnere (IFP) dhe agrobiznesit duke siguruar publikime dhe studime teknike, organizuar aktivitete rjetëzimi, fushata publike si dhe trajnime dhe ofrim të njohurive për rritje kapacitetesh.

Deri më sot janë më shumë se 6000 fermerë dhe agrobiznese në Shqipëri që kanë përfituar nga Programi AASF, dhe përtej faktit që ky vit ka qënë tepër i vështirë si pasojë e pandemisë nga coronavirus, ekipi ka vazhduar punën për të përmbushur detyrat duke gjetur rrugë të reja për të komunikuar dhe ofruar studime kyçe që ndihmojnë industrinë në përballimin e impaktit ekonomik.

Paralelisht, AASF ka punuar ngushtësisht me Qeverinë Shqiptare dhe BERZH, me qëllim promovimin e skemave të IPARD dhe ato kombëtare, si dhe programin Këshilla për Biznesin e Vogël të BERZH, një instrument i rëndësishëm për potencialin e zhvillimit të bizneseve. AASF ka siguruar linja kredie dhe skema garancie për Institucionet Financiare Partnere në

këtë program, me qëllim financimin nga ana e tyre të subjekteve të agrobiznesit me plane investimi afatmesme dhe afatgjata. Në këtë edicion të ri, do të keni mundësi të njiheni me një panoramë të gjerë mbi aktivitetet e muajve të fundit të programit. Disa prej tyre kanë të bëjnë me ndërtimin dhe përmirësimin e marrëdhënieve mes institucioneve financiare dhe agrobiznesit, organizimin e webinarëve dhe takimeve online me grupe kryesore të interesit, me qëllim rritjen e njohurive në lidhje me nevojat dhe sfidat e agrobiznesit si dhe, promovimin e studimeve të AASF.

Më tej, do t'ju njohim me "Kampionët e rinj të AASF", histori suksesi që kanë në fokus përfituesit nga programi, në funksion të përmirësimit të prodhimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të sektorit bujqësor në Shqipëri, si dhe njohja me disa aktivitete të qeverisë dhe ato mediatike në lidhje me Programin e AASF.

Mezi presim të ndajmë me ju arritjet e ardhshme të AASF-së!

Frieder Woehrmann
Drejtor i Programit, AASF

Adela Leka
Zëvendës drejtoreshë e Programit, AASF

SHTYLLAT KRYESORE TË PROJEKTIT

Mbulimi i Riskut të Parë të humbjeve ("FLRC")

Mbulimi i Riskut të Parë të humbjeve ("FLRC") - është një mekanizëm që shërben për rritjen e kreditimit i siguruar nga Qeveria e Shqipërisë, duke mbuluar 20% të humbjeve të shumës totale të nën-kredive të financuara me të ardhurat nga Linja e Kredisë së Agrobiznesit ose nga Shpërndarja e Riskut.



Lehtësitë e Shpërndarjes së Riskut të Agrobiznesit

Lehtësitë e Shpërndarjes së Riskut të Agrobiznesit, bazohet në pjesëmarrje në portofolin e pafinancuar, si një instrument i cili mbulon deri në 50% të shumës agregate të portofolit të nën-kredive të Agrobiznesit.

Linjat e kreditimit të agrobiznesit

si linjat e kredisë jo të siguruar për Institucionet Financiare Partnere në Shqipëri në financimin e subjekteve të agrobiznesit për investime afatmesme dhe afatgjata.




Asistencë Teknike

- a) Ndërtimi i kapaciteteve të Institucioneve Financiare Partnere
- b) Asistencë teknike specifike të sektorit të agrobiznesit.

01 Webinare të Programit

Muajt e fundit, AASF ka organizuar dhe ka marrë pjesë në një sërë webinaresh me temë impaktin e Covid-19 mbi produktet sezonale bujqësore dhe agrobiznesin në Shqipëri.

Kjo platformë komunikimi ka rezultuar tepër efektive në informimin e grupeve të interesit rreth informacioneve dhe studimeve empirike mbi sfidat dhe potencialin e produkteve sezonale gjatë pandemisë. Gjithashtu ajo ka



ofruar një panoramë të gjerë mundësish për të investuar nga fermerët dhe agrobizneset shqiptare.

Këto webinarë kanë tërhequr një numër të gjerë pjesëmarrësish nga sektorë dhe profesione të ndryshme, përfshirë ekspertët e AASF, përfaqësues nga Qeveria dhe BERZH, donatorë të tjerë, Institucionet Financiare Partnere të AASF (Intesa SanPaolo, ProCredit Bank, Raiffeisen Bank, OTP Bank and Fondi Besa), Shoqatën e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptar, biznese të

interesuara dhe përfaqësues nga institucionet shtetërore që mbulojnë sektorin e bujqësisë. AASF do të vazhdojë të organizojë dhe marrë pjesë në webinarë të tjera në të ardhmen, duke promovuar studime të reja lidhur me koronavirusin dhe impaktin e saj mbi produktet sektoriale në Shqipëri.

Për të parë videon e plotë të webinar-it, ju lutemi vizitoni faqen tonë:

Albania Agribusiness Support Facility.



"IPARD, Skemat Kombëtare dhe Programi AASF kanë dhënë një mbështetje të madhe për industrinë e prodhimit bujqësor duke i mundësuar asaj më shumë akses në financa." – Arben Shkodra, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptar.



02 Presenca Mediatike

Gjatë pandemisë, ekspertët e AASF janë angazhuar në mënyrë aktive në media në diskutimet rreth sfidave të agrobiznesit dhe agroturizmit gjatë periudhës së Covid-19. AASF ka kontribuar në zhvillimin e zgjidhjeve të qëndrueshme që mbështesin rikuperimin e plotë të sektorit. Z. Ilir Pilku, Ekspert i Lartë i Agrobiznesit pranë AASF, ka marrë pjesë në disa programe televizive për të diskutuar mbi mundësitë dhe sfidat gjatë dhe pas periudhës së pandemisë në sektorin



bujqësor në Shqipëri. Eksperti Pilku ka kontribuar në rritjen e cilësisë së debatit

mbi bujqësinë dhe njohurive të fermerëve përmes studimeve të fundit të AASF mbi ndikimin e Covid-19. Gjithashtu, përmes prezencës mediatike kemi një mbulim më të madh të aktiviteteve sezonale të agrobiznesit në Shqipëri, si dhe një promovim më të mirë mbi mundësitë që programi AASF, IPARD dhe Skemat Kombëtare, i sjell industrisë në përgjithësi në Shqipëri.

Për më shumë informacion ju lutemi të ndiqni faqen tone zyrtare në:

The Albania Agribusiness Support Facility (AASF).

03 Publikime

Gjatë kësaj pandemie, ekspertët e AASF kanë mundur të monitorojnë nga afër impaktin e saj mbi industrinë bujqësore në Shqipëri. Për këtë, AASF ka përgatitur dy studime mbi "Efektet e Covid-19 në produktet sezonale të Agrobiznesit". Këto studime ofrojnë për agrobiznesin një pamje të produkteve bujqësore sezonale më relevante duke nisur me sfidat e lidhura me pandeminë dhe potencialin e tyre prodhues dhe mundësitë për t'u marketuar. Disa prej produkteve sezonale në këtë studim janë perimet e serave, luleshtrydhja dhe bostani. Të dyja studimet fokusohen në



impaktin që ka patur pandemia në segmente të ndryshme të zinxhirit të vlerës duke nënvizuar implikimin e institucioneve financiare dhe klientëve të tyre. Më tej, ato na prezantojnë me mekanizmat mbështetëse dhe strategjitë për zbutjen e riskut në funksion të përbalimit të situatës dhe forcimit të qëndrueshmërisë së biznesit dhe PFI-ve.

Për të lexuar studimet e plota lutemi vizitoni faqen tonë zyrtare: www.aasf.com.al



"Sektori i agrobiznesit u përball me një situatë të pazakontë shkaktuar nga vendosja e rregullave strikte të kushtëzuara nga pandemia. Nga ana tjetër, vërejmë se fermerët nuk arrijnë të përmbushin në kohë afatet e mbjelljes. Tani është momenti, për të treguar më shumë kujdes në respektimin e këtyre afateve për produktet sezonale në fazën fillestare." – Z. Ilir Pilku, Ekspert i Lartë, AASF

KAMPIONËT E AASF

"Kampionët e AASF" janë bizneset e zgjedhura, të cilat kanë marrë mbështetje teknike dhe financiare nën Programin AASF që u mundëson atyre të rrisin produktivitetin e përdorimit të burimeve ose shtimin e vlerës. Ata shërbejnë si shembuj të modelit më të mirë përfaqësues sesi AASF kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të sektorit bujqësor shqiptar.


"Flori sh.p.k", një prodhues i qumështit me vendndodhje në Lezhë, përfitoi nga asistenca financiare përmes AASF dhe skemës IPARD ndërmjet 2016 dhe 2020. Biznesi nisi për herë të parë aktivitetin e tij në 2011, me një total prej 130 krerë lopë. Tani në vitin e tij të 10-të të aktivitetit, numri i lopëve dhe meshqerrëve është rritur në 393 dhe prodhimi ushqimit me cilësi të lartë zhvillohet në 11.6 hektarë tokë. Produktiviteti i lartë i lopëve gjermane që kjo fermë rrit sot, ka rritur prodhimin e përgjithshëm të qumështit me më shumë se 150%.



Z. Ndoc Gazulli, zooteknik përgjegjës për menaxhimin e fermës dhe sigurimin e cilësisë thotë se ai u njoh me AASF dhe IPARD përmes Institucioneve Financiare partnere të AASF. AASF dhe Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) kanë mbështetur "Flori sh.p.k" përmes asistencës financiare dhe teknike për të zgjeruar kapacitetet e saj prodhuese dhe për të ofruar shërbim më të mirë dhe me cilësi për klientët e saj. Vetëm përmes Programit AASF, këtij biznesi i'u dha mundësia të përfitojë hua që arrijnë deri në 400.000 € duke u kthyer në një nga prodhuesit më të mëdhenj të qumështit në Shqipëri.



"Përmes mbështetjes së Programit AASF dhe skemës së IPARD, ne kemi arritur të zgjerojmë kapacitetin e prodhimit dhe kemi blerë makineri dhe pajisje të reja bujqësore të nevojshme për të përshpejtuar procesin e prodhimit" - Z. Ndoc Gazulli, zooteknik përgjegjës për menaxhimin e fermës dhe sigurimin e cilësisë.



Vitet e fundit, akuakultura dhe prodhimi i produkteve të bulmetit janë zgjeruar me shpejtësi të madhe. Të dy këto sektorë kanë marrë vemendjen dhe mbështetjen e duhur si nga politikbërësit, po ashtu kanë përfituar edhe nga Programi AASF.

"Alb-Adriatico 2013" është një tjetër përfitues i AASF, me vendndodhje në qytetin e Vlorës i cili kultivon levrekun dhe produkte të tjera deti të cilat janë shumë të kërkuara nga tregu lokal dhe ai rajonal.

Z. Bledi Çuçi, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, gjatë sezonit veror në turin të vizitave të tij në agrobizneset dhe bizneset e akuakulturës në Shqipëri, ka ndaluar edhe tek "Alb-Adriatico 2013" për të diskutuar rreth zhvillimeve më të fundit në funksion të investimeve dhe projekteve për të ardhmen në këtë sektor.



Ndërsa, Znj. Anila Denaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë të Shqipërisë, ka vizituar një tjetër përfitues të Programit AASF, "Gjirofarma", për të diskutuar investimet e fundit dhe planet për të ardhmen të këtij biznesi. Me një përvojë më shumë se 15 vjeçare në treg, Gjirofarma është një prej markave shqiptare më të njohura në sektorin e bulmetit.

Falë mbështetjes nga BERZH dhe Qeveria Shqiptare, përmes Programit AASF dhe Institucioneve Partnere Financiare, "Alb-Adriatico 2013" ka mundur të rrisë kapacitetet dhe prodhimin e produkteve të detit, sikurse dhe standardet e cilësisë duke ndihmuar biznesin të futet në tregjet e BE-së. Në të njëjtën kohë Gjirofarma, ka rritur kapacitetet dhe prodhimin e bulmetrave duke shtuar edhe një linjë të produkteve të bulmetit.



Industria e akuakulturës është një sektor mjaft i rëndësishëm për ekonominë shqiptare. Në 5 muajt e fundit ai ka eksportuar 1,200 tonë produkte peshku vetëm në Bashkimin Evropian. Gjithashtu ai punëson qindra individë dhe ka një potencial të lartë prodhimi që mund të arrijë deri në 10,000 tonë në vit. - Z. Bledi Çuçi, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural



"Ne duhet të bashkëveprojmë më afër me njëri-tjetrin për të incentivuar sektorin e agrobiznesit, ne si Qeveri, në njërin anë, dhe institucionet financiare dhe fermerët nga ana tjetër përmes zhvillimit të kapaciteteve dhe formalizimit. Programet ndërkombëtare dhe partnerët tanë, janë gati për të na asistuar në çdo moment." - Zj. Anila Denaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë.

Raiffeisen Bank

Raiffeisen Bank është një nga bankat më të mëdha në vend dhe gjatë 14 viteve të fundit ka shndërruar plotësisht Bankën e vjetër të Shtetit në një bankë me shërbim të plotë që shërben për të gjithë sektorët e biznesit dhe tregjet private individuale. Banka ka një gamë produktesh, procesesh, sistemesh dhe një infrastrukturë degësh që krahasohet në mënyrë të favorshme me standardet evropiane të shekullit XX. Raiffeisen Bank ofron gamën e plotë të produkteve dhe shërbimeve bankare në 4 sektorët kryesorë të biznesit në të cilët operon - individë privatë, mikro biznes, biznes të vogël dhe biznes korporative dhe u shërben më shumë se 800,000 klientëve. Raiffeisen Bank mbështet agrobiznesin dhe fermerët në çdo aktivitet të biznesit të tyre përkundër madhësisë dhe pozicionit të tij në industri. Si çdo hua tjetër, edhe kjo është e strukturuar duke u bazuar në ciklin e biznesit bujqësor.

(W): <https://www.raiffeisen.al/>



Pro Credit Bank

ProCredit Bank është një bankë tregtare e orientuar drejt zhvillimit. Banka ofron shërbim të shkëlqyeshëm për klientët, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe për individët privatë që kanë aftësinë për të kursyer dhe që preferojnë të kryejnë veprimet e tyre bankare përmes kanaleve elektronike. Fokusi i tyre është tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, pasi janë të bindur se këto biznese krijojnë vende pune dhe japin një kontribut jetik për ekonominë në të cilat operojnë. Një nga strategjitë kryesore për huadhënien është mbështetja e klientëve që merren me prodhim dhe bujqësi.

(W): <https://www.procreditbank.com.al/>



Intesa San Paolo

Intesa Sanpaolo Bank është një nga bankat më të mëdha në vend që ofron një gamë të gjerë zgjidhjesh financiare, produkte dhe shërbime novatore për klientët e korporatave, klientët privatë institucionalë dhe me të ardhura të larta, si dhe bizneset e vogla dhe të mesme dhe klientët individualë. Intesa Sanpaolo Bank Albania ka një rrjet prej 35 degësh në qytete të ndryshme të vendit dhe po zgjerohet më tej strategjikisht në të gjithë Shqipërinë. Risia dhe përsosmëria e shërbimeve në Intesa Sanpaolo Bank Albania janë frymëzuar nga klientët e saj. Një nga strategjitë e Bankës Intesa Sanpaolo në Shqipëri është zgjerimi i portofolit të saj në agrobiznes, duke mbështetur posaçërisht bizneset e vogla dhe fermerët me zgjidhje financiare të përshtatura.

(W): <https://www.intesasanpaolobank.al/>



Fondi Besa

Fondi Besa, me 80 zyra në të gjithë Shqipërinë, synon të jetë i pranishëm aty ku ka nevojë për zhvillim, duke ofruar mundësi aksesit për mijëra njerëz, përmes mbështetjes me shërbime financiare, krijimit të lidhjeve midis klientëve dhe mundësive për të kontribuar në zhvillimin më të mirë ekonomik të vendit.

(W): <https://fondibesa.com/>



Otp Bank

OTP Bank si një lojtar dominues bankar në Hungari dhe rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore ofron shërbime financiare me cilësi të lartë për më shumë se 18,5 milion klientë privatë dhe korporata në nëntë vende përmes pothuajse 1500 degëve të saj, rrjeteve të agjentëve, 3900 ATM-ve, kanaleve të internetit dhe elektronike. Zhvillimi dhe zgjerimi i vazhdueshëm i OTP Bank ka kontribuar ndjeshëm në funksionimin e suksesshëm dhe efikas të grupit bankar, i cili ofron shërbime me cilësi të lartë si për klientët me pakicë ashtu edhe për institucionet. Megjithë konkurrencën e fortë, pozicioni i tregut të OTP Bank është i qëndrueshëm në disa segmente, si dhe përsa i përket përfitimit dhe stabilitetit, banka i takon vijës evropiane. Ndonëse OTP Bank është një lojtar i ri në tregun bankar shqiptar, sektori i agrobiznesit është një nga segmentet kryesore të synuara për mbështetjen e tyre financiare.

(W) <https://otpbank.al/>



AZHBR

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) është një agjenci kombëtare shtetërore që synon të mbështesë sipërmarrësit shqiptarë në sektorin e bujqësisë dhe ushqimit, duke përgatitur institucionin të përfitojë nga fondet e BE-së dhe donatorëve të tjerë. AZHBR po mbështet sektorin drejt rristurimit, modernizimit dhe specializimit në produkte dhe tregje specifike bazuar në avantazhet konkurruese të vendit. AASF është që prej vitit 2016 duke bashkëpunuar me AZHBR për të mbështetur fermerët dhe agrobiznesin në Shqipëri përmes ndihmës teknike dhe mbështetjes financiare.

(W): <http://www.azhbr.gov.al/>



AASF

Rr. Andon Zako Çajupi, No.7,
Tiranë, Albania

(T): +355 69 294 1513
(E): info@aasf.com.al
(W): www.aasf.com.al

Na ndiqni në grupin tonë
të LinkedIn:

The Albania Agribusiness
Support Facility (AASF)